



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 18 dhjetor 2017
Nr. ref.: RK 1175/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI129/16

Parashtrues

“KOSBAU GmbH”

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, E.
Rev. nr. 21/2016, të 2 qershorit 2016**

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga “KOSBAU GmbH”, e regjistruar në Kosovë si kompani e huaj me zyrë në Tërstenik, Glogoc (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës) që përfaqësohet nga Shaqir Behrami dhe Visar Morina, avokat dhe profesor i së drejtës, respektivisht.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës [E. Rev. nr. 21/2016] i 2 qershorit 2016, i cili iu dorëzua parashtruesit të kërkesës më 22 korrik 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e Pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: Konventa).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 11 nëntor 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 12 dhjetor 2016, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin nr. GJR. KI129/16 caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.
7. Më 22 dhjetor 2016, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
8. Të njëjtën ditë, Gjykata Supreme dhe Komuna e Gllogocit (në tekstin e mëtejme: Komuna) u njoftuan për regjistrimin e kërkesës dhe atyre iu dorëzua një kopje e kërkesës.
9. Më 13 nëntor 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 3 nëntor 2009, parashtruesi i kërkesës lidhi Kontratën nr. 611-09-101-521 (në tekstin e mëtejme: Kontrata) me Komunën për rinovimin e Sheshit "Fehmi Lladrovci" në vlerë prej 61.718,29 euro.

11. Parashtruesit të kërkesës i ishte paguar në tërësi shuma monetare e specifikuar në Kontratë. Megjithatë, pas plotësimit të kushteve të parapara me Kontratë, sipas parashtruesit të kërkesës, me kërkesë të bërë gojarisht nga Komuna, ai vazhdoi punimet shtesë edhe për 90 (nëntëdhjetë) ditë të tjera për përfundimin e sheshit. Nuk ishte nënshkruar asnjë kontratë shtesë ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe Komunës. Puna shtesë u krye në shumën prej 135.760,18 euro, siç tregohet në faturat që i janë dorëzuar Komunës nga parashtruesi i kërkesës. Kjo shumë asnjëherë nuk u kompensua nga Komuna.
12. Më 10 shtator 2012, parashtruesi i kërkesës parashtroi në Gjykatën Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) propozim për përmbarim lidhur me borxhin në shumën e përgjithshme prej 135.760,18 euro kundër Komunës. Parashtruesi i kërkesës specifikoi se *“nëse Komuna paraqet kundërshtimin e saj eventual, atëherë i propozon gjykatës që këtë propozim ta konsideroj si padi.”*
13. Më 11 shtator 2012, Gjykata Themelore nxori vendim për aprovimin e propozimit të parashtruesit për përmbarim. Megjithatë, brenda afatit ligjor, Komuna parashtroi kundërshtim kundër këtij propozimi, duke arsyetuar se Komuna *“ndaj kreditorit nuk ka asnjë detyrim ashtu siç qëndron në propozimin e tij për përmbarim, dhe me kreditorin nuk ka pasur marrëveshje të kontraktuar për punimet e kryera”*.
14. Pas kundërshtimit të Komunës, Gjykata Themelore shfuqizoi vendimin për aprovimin e propozimit të parashtruesit të kërkesës për përmbarim dhe vendosi të vazhdojë vlerësimin e padisë së parashtruesit të kërkesës në bazë të procedurës kontestimore.
15. Më 5 janar 2015, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin [C. nr. 411/2012], duke refuzuar pretendimin e parashtruesit të kërkesës si tërësisht të pabazuar. Në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, ndër të tjera, arsyetohej se sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në tekstin e mëtejme LMD), puna ndërtimore duhet të kryhet në bazë të kontratës paraprake me shkrim ndërmjet palëve, kusht ky që nuk ishte plotësuar në rastin konkret.
16. Më 5 janar 2015, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë ndaj Aktgjykimit [C. nr. 411/2012] të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore; vërtetim të gabuar të gjendjes faktike; dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës kryesisht pohoi se kontrata ndërmjet tij dhe Komunës nuk duhet të konsiderohet si një kontratë ndërtimi, por një kontratë mbi vepër për të cilën nuk kërkohet pëlqimi me shkrim. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendoi se Komuna jo vetëm që kërkoi, por asnjëherë nuk e kundërshtoi punën e kryer nga parashtruesi i kërkesës.
17. Më 14 mars 2016, Gjykata e Apelit e Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) përmes Aktgjykimit të saj [Ae. nr. 90/2015] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit, në trajtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, theksoi se, si organizatë e specializuar për punimet e ndërtimit, parashtruesi i kërkesës duhet ta ketë ditur se pa kontratë me shkrim

apo pa ndryshimin e Kontratës kryesore nuk mund të kryhej asnjë punë, veçanërisht duke pasur parasysh se Kontrata kryesore përcakton qartë se nuk lejohet puna shtesë që tejkalon shumën e kontraktuar.

18. Parashtruesi i kërkesës parashtroi revizion kundër Aktgjykimit [Ae. nr. 90/2015] të Gjykatës së Apelit duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke ngritur të njëjtat pretendime të ngritura para Gjykatës së Apelit.
19. Më 2 qershor 2016, Gjykata Supreme [E. Rev. nr. 21/2016] e refuzoi revizionin e parashtruesit të kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit si të pabazuar. Gjykata Supreme, ndër të tjera, arsyetoi se nuk ka asnjë bazë ligjore për të realizuar të drejtën e kompensimit për punët e kryera nga parashtruesi i kërkesës, pasi që punët shtesë nuk ishin autorizuar nga autoriteti kontraktues, duke qenë autoriteti i vetëm kompetent për dhënien e pëlqimit për punët shtesë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 21/2016] shkel të drejtat e tij të garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 (Mbrojtja e Pronës) të Konventës.
21. Sa i përket shkeljeve të pretenduara të nenit 46 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson se Komuna kërkoi punë shtesë për përfundimin e sheshit, duke i lejuar parashtruesit të kërkesës të ndërmarrë investime serioze financiare “*duke mos ofruar kompensim për punët e kryera*”. Parashtruesi i kërkesës shtoi se gjatë 90 (nëntëdhjetë) ditëve të kryerjes së punës shtesë, Komuna asnjëherë nuk e paralajmëroi parashtruesin e kërkesës “*me asnjë veprim apo shpresë që për kryerjen e kësaj pjese shtesë në shesh do të procedohet me kontratë të veçantë*”. Përkundrazi, Komuna lejoi dhe mbikëqyri punimet e kryera nga parashtruesi i kërkesës.
22. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës konsideron se Komuna, si autoritet publik, ka detyrime pozitive për të mbrojtur të drejtat e pronës së individëve, duke përfshirë edhe parashtruesin e kërkesës. Mungesa e çdo veprimi të Komunës për të informuar dhe për të parandaluar parashtruesin e kërkesës që të bëjë investime në Sheshin e Komunës, sipas parashtruesit të kërkesës, përbën shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës. Në lidhje me detyrimin pozitiv të shtetit për të mbrojtur pronën e individëve, parashtruesi i kërkesës i referohet rastit *Zolatas kundër Greqisë* të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ).
23. Edhe pse nuk pretendon shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në mënyrë specifike, parashtruesi i kërkesës më tutje pohon se gjykatat e rregullta nuk kanë adresuar pretendimet e tij për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, veçanërisht për sa i përket detyrimeve pozitive të autoritetit publik për mbrojtjen e të drejtave pronësore.

24. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se në një rast të ngjashëm [Aktgjykimi E. Rev. 35/2013 të 9 dhjetorit 2013], Gjykata Supreme, kur vendosi për kompensimin e borxhit në emër të punëve shtesë për rregullimin e sistemit të kanalizimit në një nga fshatrat në Prishtinë, detyroi Qeverinë e Kosovës të paguante për punët shtesë të kryera nga D. H., për shkak të faktit se “faturat e dërguara nga paditësi nuk ishin kundërshtuar”.
25. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata Kushtetuese ta aprovojë kërkesën si të pranueshme dhe të deklarojë shkelje të nenit 46 [Mbrotja e Pronës] në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrotja e Pronës) të Konventës dhe ta anulojë Aktgjykimin [Rev. 21/2016] të Gjykatës Supreme, duke e kthyer çështjen për rigjykim.

Pranueshmëria e kërkesës

26. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i përmbush kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

28. Në vazhdim, Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç specifikohet më tej në Ligj dhe në Rregullore. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

*Neni 48
Saktësimi i kërkesës*

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

*Neni 49
Afatet*

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.”

29. Lidhur me përmbushjen e këtyre kërkesave, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, që konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 21/2016] të 2 qershorit 2016, pas shterjes së të gjitha mjeteve juridike të parapara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka specifikuar me saktësi të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe Konventë që pretendohet se janë shkelur në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe ka parashtruar kërkesën brenda afatit prej 4 (katër) muajsh të paraparë në nenin 49 të Ligjit.
30. Përveç kësaj, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 36 (1) i Rregullores së punës specifikon kushtet sipas të cilave Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë, duke përfshirë kushtin që kërkesa e tillë të mos jetë qartazi e pabazuar. Sipas rregullit 36 (2), një kërkesë është qartazi e pabazuar nëse Gjykata bindet se:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

31. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 21/2016] të 2 qershorit 2016, duke pretenduar që, i) Gjykata Supreme nuk ka shqyrtuar kërkesën e tij për pagesë për punët shtesë të kryera në shesh në dritën e së drejtës për pronë siç garantohet me Kushtetutë; ii) Komuna, si autoritet publik, në bazë të Kushtetutës, Konventës dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, ka detyrim pozitiv për të parandaluar që parashtruesi të ndërmarrë investime, të cilat sipas mendimit të Komunës, nuk kishin bazë ligjore dhe iii) Gjykata Supreme në një rast të ngjashëm me atë të parashtruesit të kërkesës ka vendosur ndryshe, duke ngritur kështu çështje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E Drejta në Gjykim të Drejtë) të Konventës.

Sa i përket shkeljes së pretenduar të së drejtës për mbrojtje të pronës

32. Gjykata së pari kujton përmbajtjen e nenit 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës:

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës:

- “1. E drejta e pronës është e garantuar.*
- 2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
- 3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet.*
[...]

Neni 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit nr. 1 të Konventës:

- 1. Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.*
 - 2. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.”*
33. Përmbajtja e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës dhe zbatimi i saj janë interpretuar nga GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore, ndërsa Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Rrjedhimisht, në lidhje me interpretimin e pretendimeve për shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1, Protokollin nr. 1 të Konventës, Gjykata do t'i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.
34. Sa i përket të drejtave të garantuara dhe të mbrojtura me nenin 46 të Kushtetutës, Gjykata së pari thekson se paragrafit 1 i nenit 46 të Kushtetutës e garanton të drejtën e pronës; paragrafi 2 i nenit 46 të Kushtetutës përcakton mënyrën e shfrytëzimit të pronës, duke specifikuar qartë se shfrytëzimi i saj rregullohet me ligj dhe në pajtim me interesin publik dhe në paragrafin 3, garanton që askush nuk mund të privohet nga prona në mënyrë arbitrare, duke përcaktuar gjithashtu kushtet në të cilat prona mund të eksproprijohet. (shih, *mutatis mutandis*, Rasti KI50/16, Parashtrues i kërkesës Veli Berisha dhe të tjerët, Aktvendimi për papranueshmëri i 10 marsit 2017, prg. 31).

35. Sa i përket të drejtave të garantuara dhe të mbrojtura me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës, Gjykata vëren se GJEDNJ ka konstatuar se e drejta e pronës përbëhet nga tri rregulla të ndryshme. Rregulli i parë, i cili ka natyrë të përgjithshme, formulon parimin e gëzimit paqësor të pasurisë; kjo përcaktohet në fjalinë e parë të paragrafit të parë. Rregulli i dytë përfshin privimin nga pasuria dhe ia nënshtrohet të njëjtin kushteve të caktuara; kjo përcaktohet në fjalinë e dytë të të njëjtin paragraf. Rregulli i tretë ua njeh shteteve, ndërmjet të tjerash, të drejtën për të kontrolluar shfrytëzimin e pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm, duke zbatuar ato ligje që ato i çmojnë të nevojshme për këtë qëllim; kjo përcaktohet në paragrafin e dytë. (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 23 shtatorit 1982, *Sporrong dhe Lonnrot kundër Suedisë*, nr. 7151/75; 7152/75, para. 61).
36. Të tri rregullat nuk janë, megjithatë, “të ndryshme” në kuptim e të qenurit të pa ndërlidhura. Rregulli i dytë dhe i tretë kanë të bëjnë me raste të veçanta të ndërhyrjes në të drejtën për gëzimin paqësor të pronës dhe prandaj duhet të interpretohen në dritën e parimit të përgjithshëm të përcaktuar në rregullin e parë. (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 shkurtit 1986, *James dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 8793/79, paragrafi 37).
37. Përveç kësaj, koncepti i “pasurisë” dhe “pritjeve legjitime” kanë një vend qendror në interpretimin e të drejtave pronësore të garantuara me Konventë dhe të zhvilluara më tej me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.
38. Sa i përket të parit, GJEDNJ-ja vazhdimisht ka konstatuar se koncepti i “pasurisë” në kuptim të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës ka një kuptim autonom që nuk kufizohet në pronësinë e të mirave materiale dhe është i pavarur nga klasifikimi formal në ligjin vendor: disa të drejta dhe interesa të tjera që përbëjnë pasuri, gjithashtu mund të konsiderohen si “të drejta pronësore”, dhe si të tilla “pasuri”. (Shih, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 13 dhjetorit 2016, *Bélané Nagy kundër Hungarisë*, nr. 53080/13, para. 73 dhe 75, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 22 qershorit 2004, *Broniowski kundër Polonisë*, nr. 31443/96, paragrafi 129).
39. Nga ana tjetër, “pritjet legjitime mund të rezultojnë në pasuri”. Edhe pse neni 1 i Protokollit nr. 1 zbatohet vetëm për pasurinë ekzistuese të një personi dhe nuk krijon të drejtën e fitimit të pronës, në rrethana të caktuara, një “pritje legjitime” për fitimin e një prone mund të gëzojë gjithashtu mbrojtjen e nenit 1 të Protokollit nr. 1. (Shih, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 13 dhjetorit 2016, *Bélané Nagy kundër Hungarisë*, nr. 53080/13, para. 73 dhe 75, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 22 qershorit 2004, *Broniowski kundër Polonisë*, nr. 34443/96 paragrafi 129).
40. Megjithatë, Gjykata rikujton se GJEDNJ gjithashtu konsideron se: “pritja legjitime” duhet të jetë e një natyre më konkrete sesa thjeshtë një shpresë dhe të jetë e bazuar në një dispozitë juridike ose akt juridik siç është për shembull një vendim gjyqësor. (Shih, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 13 dhjetorit 2016, *Bélané Nagy kundër Hungarisë*, nr. 53080/13, para. 75). Nuk mund të thuhet se “pritja legjitime” paraqitet në rastet kur ekziston një mosmarrëveshje në lidhje

me interpretimin dhe zbatimin e drejtë të ligjit, dhe kur kërkesat e parashtruesve pastaj refuzohen nga gjykatat e rregullta. (shih: *mutatis mutandis*, *Bélané Nagy kundër Hungarisë*, Ibidem, para.75).

41. Në rastin konkret, pretendimi i parashtruesit të kërkesës hyn në kuadër të rregullit të parë të përcaktuar në fjalinë e parë të paragrafit të parë të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës - gëzimin paqësor të pasurisë. Kjo garanci gjithashtu përfshin, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, detyrimet pozitive të shtetit për mbrojtjen e pasurisë, të cilave parashtruesi i kërkesës i referohet dhe pretendon se përbëjnë shkelje të të drejtave pronësore në rastin e tij.
42. Gjykata rikujton që GJEDNJ në këtë drejtim konsideron se “*Ushtrimi i vërtetë dhe efektiv i të drejtave të mbrojtura nga kjo dispozitë nuk varet thjesht nga detyrimi i shtetit për të mos ndërhyrë, por mund të kërkohej që të marrë masa mbrojtëse pozitive, veçanërisht kur ka një lidhje të drejtpërdrejt midis masave të cilat një parashtrues mund të presë në mënyrë legjitime nga autoritetet dhe gëzimin efektiv të pasurisë së tij*”. (Shih, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 30 nëntorit 2004, *Oneryildiz kundër Turqisë*, nr. 48039/99, para. 134).
43. Megjithatë, në përcaktimin nëse koncepti i detyrimeve pozitive, parandaluese ose përmirësuese, për të mbrojtur gëzimin paqësor të pasurisë zbatohet në rrethanat e parashtruesit të kërkesës, së pari, çështja që duhet shqyrtuar në rastin në fjalë është nëse rrethanat e rastit, të shqyrtuara në tërësi, i dhanë parashtruesit të kërkesës një titull të një interesi përmbajtësor të mbrojtur me nenin 46 të Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1. (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i KEDNJ-së i 22 qershorit 2004, *Broniowski kundër Polonisë*, nr. 31443/96, paragrafi 129).
44. Gjykata rikujton se përderisa “pritjet legjitime mund të rezultojnë në pasuri”, një “pritje legjitime” duhet të jetë e një natyre konkrete, të bazohet në dispozita ligjore ose në një vendim gjyqësor dhe se nuk mund të lindë aty ku ka një mosmarrëveshje rreth interpretimit të saktë ose zbatimit të ligjit të aplikueshëm.
45. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të sigurojë një kontratë me shkrim ose ndryshim të Kontratës ekzistuese për kryerjen e punëve shtesë në shesh, që parashtruesi i kërkesës pretendon që i ishte kërkuar nga Komuna, siç kërkohej nga LMD. Gjykata gjithashtu rikujton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë refuzuar nga gjykatat e rregullta, përkatësisht nga Gjykata Themelore, ajo e Apelit dhe Gjykata Supreme.
46. Gjykata rikujton që Gjykata Themelore [Aktgjykimi C. nr. 411/2012] bazoi, ndër të tjera, vendimin e saj në arsyet se nuk kishte “*pëlqim paraprak me shkrim nga [Komuna], nuk ka as aneks kontratë lidhur me kryerjen e këtyre punimeve*” siç kërkohej me legjislacionin e aplikueshëm.
47. Gjykata Themelore gjithashtu i adresoi argumentet e parashtruesit të kërkesës se puna shtesë nuk do të duhej të konsiderohej si një kontratë ndërtimi, por si një kontratë mbi vepër. Gjykata Themelore, duke iu përgjigjur këtij pretendimi, arsyetoi:

“bazuar në dispozitën e nenit 630 të LMD-së, kjo është kontratë e ndërtimit sepse si e tillë është paraparë në përkufizimin e punëve të cekur në kushtet e përgjithshme të kontratës së datës 03.11.2009, andaj në këtë rast nuk kemi të bëjmë me kontratë mbi veprën si pretendon pala paditëse në deklarin e tij në fjalën përfundimtare të hartuar me shkrim.”

48. Gjkata vëren se arsyetimi i miratuar nga Gjkata Themelore u vërtetua nga Gjkata e Apelit, e cila ndër të tjera, arsyetoi që:

“[Parashtruesi i kërkesës] si kryes i punimeve është organizatë e specializuar për kontraktimin e punimeve ndërtimore dhe si e tillë e ka ditur, respektivisht ka qenë dashur ta dijë, se pa pëlqim, pa aneks kontratë, nuk mund të kryhet asnjë punë e cila nuk është paraparë me kontratë. Madje këtë fakt [parashtruesi i kërkesës] e ka pas të njohur, pasi që në kontratën e nënshkruar në Nenin 2.2, Nenin 21 dhe 28.4 të kontratës përcaktohet qartë se nuk lejohen punë shtesë të cilat tejkalojnë çmimin e kontraktuar”.

49. Gjkata gjithashtu përsërit se Gjkata Supreme, mes tjerash, arriti në përfundimin se:

“punët shtesë nuk janë autorizuar nga autoriteti kontraktues si i vetmi autoritet kompetent për marrjen e pëlqimit për punët shtesë apo përmes marrjes së pëlqimit nga [Agjencia për Prokurim Publik] për lidhjen e kontratës, përmes procedurës së negociuar, në këtë rast [parashtruesi i kërkesës] nuk ka bazë ligjore për të realizuar të drejtën në kompensimin e punëve shtesë, ashtu si drejt kanë vlerësuar të dy gjykatat”.

50. Në lidhje me këtë, Gjkata konsideron se përfundimet e Gjykatës Themelore, të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme janë arritur pas një shqyrtimi të hollësishëm të të gjitha argumenteve të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës. Në këtë mënyrë, parashtruesit të kërkesës i është dhënë mundësia të paraqesë në të gjitha fazat e procedurës argumentet dhe provat që ai i konsideronte të rëndësishme për rastin e tij.

51. Të gjitha argumentet e parashtruesit të kërkesës, të cilat kanë qenë relevante për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, janë dëgjuar dhe shqyrtuar siç duhet nga gjykatat dhe Gjkata konkludon se procedurat në gjykatat e rregullta, të shikuara në tërësinë e tyre, ishin të drejta. (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30).

52. Duke pasur parasysh sa më sipër, dhe në rrethanat e rastit si tërësi, Gjkata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka vërtetuar se me rrethanat e rastit i është dhënë parashtruesit të kërkesës një “pritje legjitime” e mbrojtur në bazë të së drejtës në pronë sipas nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës. Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së në mënyrë të qartë thekson se nuk mund të lind një “pritje legjitime” kur ekziston një mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin e drejtë dhe zbatimin e së drejtës vendore dhe parashtruesat e parashtruesit më pas refuzohen nga gjykatat

vendore. (Shih, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 13 dhjetorit 2016, *Bélané Nagy kundër Hungarisë*, nr. 53080/13, paragrafi 75).

53. Gjykata gjithashtu rikujton që parashtruesi i kërkesës, duke u bazuar në Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Zolotas kundër Greqisë* (nr. 2), pretendon se shteti ka një detyrim pozitiv për të mbrojtur të drejtën e pronës së qytetarit, kështu që do të ishte legjitime për parashtruesin e kërkesës në këtë rast të presë që të njoftohet ose të parandalohet nga Komuna që të vazhdojë të bëjë investime të cilat e vënë interesin e tij financiar në rrezik. Parashtruesi i kërkesës konsideron se një njoftim me kohë lidhur me këtë situatë nga ana e Komunës, si autoritet publik, do të kishte rezultuar në veprime të parashtruesit të kërkesës që do të siguronin që puna do të kryhej në pajtim me ligjin, dhe kështu do të ishte në gjendje të ruante dhe të mbronte të drejtën e tij në pronë.
54. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se në Aktgjykimin e mësipërm (*Zolotas kundër Greqisë* (nr. 2)), GJEDNJ-ja konstatoi se: *“Shteti ka një detyrim pozitiv për të mbrojtur qytetarët dhe për të kërkuar që bankat, duke pasur parasysh pasojat e mundshme negative të periudhave të kufizimit, duhet të informojnë mbajtësit e llogarive joaktive, kur ka skaduar afati i kufizimit dhe kështu t’u ofrojnë atyre mundësinë për të ndaluar periudhën e kufizimit që rrjedh, duke kryer, për shembull, një transaksion në llogari”*. Prandaj, duke mos njoftuar mbajtësit e llogarive për periudhën e kufizimit, banka “i ka vendosur mbajtësit e llogarive, veçanërisht kur ata janë qytetarë të zakonshëm, pa përvojë në të drejtën civile ose bankare, në një disavantazh kundrejt bankës apo edhe shtetit”. (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 29 janarit 2013, *Zolotas kundër Greqisë* (nr. 2), kërkesa nr. 66610/09, paragrafi 53).
55. Megjithatë, përveç mungesës së një “pritjeje legjitime”, Gjykata gjithashtu vëren se rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës ndryshojnë nga rrethanat e rastit *Zolotas kundër Greqisë* (nr. 2), sepse siç, ndër të tjera, përcaktohet nga Gjykata e Apelit, parashtruesi i kërkesës është një organizatë e specializuar për kontraktimin e punëve ndërtimore, dhe si e tillë, ka qenë në gjendje të dijë se pa një kontratë me shkrim ose shtojcë të Kontratës ekzistuese, nuk mund të kryhen punë shtesë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Prandaj, pa paragjykuar nëse veprimet e Komunës ishin të duhura, ky pretendim i parashtruesit të kërkesës nuk është i bazuar.

Sa i përket pretendimeve të parashtruesit lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm

56. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme në një rast që është i ngjashëm me atë të parashtruesit të kërkesës ka vendosur ndryshe, duke ngritur çështje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenit 6 të Konventës.
57. Në këtë rast, Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila *inter alia*, ka theksuar: *“[...] përveç në rast të arbitraritetit të dukshëm, nuk është roli i Gjykatës që të vë në pikëpyetje interpretimin e të drejtës vendore nga gjykatat nacionale (shih, Adamsons kundër Letonisë, Nr. 3669/03, 10 maj 2007). Ngjashëm, në këtë kuptim, parimisht nuk është funksioni i saj që të krahasojë vendimet e ndryshme të gjykatave nacionale, edhe nëse janë*

nxjerrë në procedura dukshëm të ngjashme; gjykata duhet të respektojë pavarësinë e atyre gjykatave [...]” (Aktgjykim i GJEDNJ i 20 tetorit 2011, Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë, nr. 13279/05, paragrafi 50).

58. Gjukata vëren se parashtruesi në mënyrë specifike i referohet Aktgjykimit të Gjukatës Supreme [Rev. nr. 35/2013, të 9 dhjetorit 2013] të dorëzuar në Gjukatë, me të cilin Gjukata Supreme e ka refuzuar si të pabazuar revizionin kundër Aktgjykimit të Gjukatës së Apelit, me të cilin ishin aprovuar konkluzionet e Gjukatës Themelore për të detyruar një institucion qeveritar të paguajë për punët shtesë të kryera nga një kontraktues, të cilat nuk ishin paraparë në kontratën fillestare.
59. Në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës, Gjukata sërish i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila ka pranuar se: *“Një shkallë e caktuar dallimesh në interpretimet ligjore [nga gjykatat] mund të pranohet si një tipar i qenësishëm i çdo sistemi gjyqësor [...] Megjithatë, dallimet thelbësore dhe për një kohë të gjatë në praktikën e gjykatave të larta vendore mund të jenë vetvetiu në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike”.* (shih rastet e GJEDNJ-së, Beian kundër Rumanisë, kërkesa nr. 30658/05, Aktgjykim i 6 marsit 2008, paragrafi 39 dhe Tomić dhe të tjerët kundër Malit të Zi, kërkesat nr. 18650/09, 18676/09, 18679/09, 38855/09, 38859/09, 38883/09, 39589/09, 39592/09, 65365/09 dhe 7316/10, Aktgjykim i 17 prillit 2012, paragrafi 53).
60. Megjithatë, GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore ka përcaktuar kriteret për vlerësimin e kushteve në të cilat vendimet kundërtënëse të gjykatave të shkallës së fundit janë në kundërshtim me të drejtën për gjykim të drejtë, përkatësisht, duhet vërtetuar nëse ekzistojnë dallime të thella dhe të vazhdueshme në praktikën gjyqësore të gjykatave të vendit, nëse ligji i vendit përcakton mekanizëm për tejkalimin e këtyre mospërputhjeve, nëse ky mekanizëm është zbatuar dhe nëse po, deri në çfarë mase. (Shih *mutatis mutandis* rastin e GJEDNJ-së Iordan Iordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë, Kërkesa nr. 23530/02, Aktgjykim i 2 tetorit 2009, paragrafët 49-52).
61. Në rastin konkret, Gjukata konstaton se parashtruesi i kërkesës i është referuar dhe ka dorëzuar vetëm një Aktgjykim të Gjukatës Supreme [Rev. nr. 35/2013, të 9 dhjetorit 2013], që parashtruesi i kërkesës pretendon se në rrethana të ngjashme faktike ka interpretuar ndryshe të drejtën materiale.
62. Megjithatë, në dritën e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjukata konsideron se nuk është e mundur të konstatohet ekzistenca e dallimeve të thella dhe të vazhdueshme në praktikën gjyqësore të Gjukatës Supreme që rrezikon parimin e sigurisë juridike, duke u thirrur vetëm në një Aktgjykim të Gjukatës Supreme, të nxjerrë rreth 4 (katër) vjet më parë.
63. Përveç kësaj, Gjukata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka shpjeguar dhe argumentuar se si rasti i tij është i ngjashëm me rastin tjetër të vendosur nga Gjukata Supreme, në të cilin është thirrur parashtruesi i kërkesës. Parashtruesi i kërkesës vetëm konkludoi se Gjukata Supreme e detyroi Qeverinë *“të paguajë borxhin në emër të punëve shtesë për rregullimin e sistemit të ujërave të zeza,*

pasi Komisioni i të paditurës konkludoi se punimet janë përfunduar edhe për shkak të faktit që faturat e dorëzuara nga parashtruesit i kërkesës nuk janë kundërshtuar”.

64. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur prova dhe as nuk i ka dëshmuar pretendimet e tij për shkeljen e të drejtave të tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe për barazi para ligjit. Kur pretendohen shkelje të tilla kushtetuese, parashtruesi i kërkesës duhet të ofrojë justifikim të arsyetuar dhe argumente bindëse. (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI45/15, *Elizabeta Arifi*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 prillit 2016, paragrafi 49).
65. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të tregojë dhe të dëshmojë se procedurat në Gjykatën Supreme kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të tij të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur përmes interpretimit, siç pretendohet, të gabuar të ligjit përkatës. Gjykata rithekson se, interpretimi i ligjit është çështje vetëm për gjykatat e rregullta dhe është çështje e ligjshmërisë. Asnjë çështje kushtetuese nuk është dëshmuar nga parashtruesi i kërkesës. (Shih, rasti KI63/16, parashtrues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, para. 44. dhe shih, gjithashtu rastin KI150/15; KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16 dhe KI64/16, parashtrues të kërkesës *Arben Gjokaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushtaku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, para. 62).
66. Në lidhje me këtë, Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të nxjerrë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si “gjykatë e shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur për juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rastin e 21 janarit 1999, *García Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, i, par. 28 dhe shih, gjithashtu rastin: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
67. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me konkluzionet e vendimit të gjykatave të rregullta. Megjithatë, fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e vendimeve të gjykatave të rregullta nuk mund të ngrejë në vetvete një pretendim të argumentueshëm për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të garantuar me Kushtetutë. (Shih, *mutatis mutandis*, rasti i GJEDNJ-së *Mezotur Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
68. Prandaj, Gjykata konsideron se nuk janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullore të punës, pasi që kërkesa duhet

të konsiderohet si qartazi e pabazuar sepse faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkelje të të drejtave kushtetuese dhe se parashtruesi i kërkesës nuk e dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

69. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, siç parashihet në nenin 48 të Ligjit dhe siç specifikohet më tej me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113 (7) të Kushtetutës, të nenit 48 të Ligjit dhe të rregullit 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 13 nëntor 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Gresa Caka-Nimani



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi